

Në bazë të nenit 8 paragrafi 2 dhe nenit 13 paragrafi 1, lidhur me nenin 38 të Ligjit për përmendoret („Fleta Zyrtare e Malit të Zi“, nr. 40/08, 40/11 i 2/17) dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Ulqinit („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale“, nr. 48/2019), në bazë të pëlqimit të Qeverisë së Malit të Zi - Përfundimi nr. 07-7785 i datës 19.12.2019, Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e datës 30.12.2019 miratoi këtë

## **PROGRAM**

### **për ngritjen e përmendoreve për vitin 2020**

#### **Hyrje**

Me këtë program, në bazë të Ligjit për përmendoret („Fleta Zyrtare e Malit të Zi“, nr. 40/08, 40/11 i 2/17) përcaktohen monumentet dhe përmendoret në territorin e komunës së Ulqinit në vitin 2020 që do të ngriten, modifikohen, përpunohen, zhvendosen dhe ndërrohen si dhe, mënyra e ngritjes, shpjegimi i domethënies simbolike dhe elementet e tjera për ekzekutimin e Programit.

Me përmendore, sipas nenit 1 të ligjit të cituar, në mënyrë të përhershme shënohen ngjarjet domethënëse, ruhen kujtimet në një personalitet të shquar, ruhen idealet dhe traditat kulturo-historike dhe nderohen luftarët për liri, viktimat civile dhe vdekjet masive të njerëzve.

Përmendore është një objekt i cili me pamjen, përmbajtjen, shënjat ose mbishkrim kontribuon në ruajtjen e përhershme të vlerave nga paragrafi 2 i këtij Programi.

## **Ngritja e pllakës përkujtimore për viktimat e termetit të 15.04.1979**

1. Më 15.04.1979 Ulqini ka pësuar një thyerje infrastrukture dhe shpirtërore nga termeti i kësaj date, e cila i morri jetën 30 qytetarëve. Sipas kësaj ngjarjeje është bërë edhe periodizimi joformal i historisë së qytetit dhe shpesh, në biseda dëgjohet ndarja e kohës „pas ose para termetit”.

Kjo ditë duhet shënuar jo vetëm për të kujtuar viktimat, por edhe për shkak se Ulqini në mënyrë simbiotike jeton me rrezikun e termetit që 2500 vjet. Përmendore të ngjashme janë ngritur në shumë qytete të botës të goditur nga termeti si në Itali, Kinë, Armeni etj.

Përmendorja në mënyrë dinjitoze do të kujtojë viktimat dhe do të mbajë edhe simbolikën e vërejtjes në fuqinë shkatërruese të termetit dhe, rrjedhimisht, do të ketë një rol edukativ lidhur me ndërtimin aseizmik. Për më tepër, kjo përmendore do të jetë tregues i ndjeshmërisë sonë ndaj të së kaluarës dhe do të jetë një pasurim kulturo-historik i qytetërimit tonë.

Vendi më i përshtatshëm për këtë përmendore është afërsia e Kalasë dhe molit për këto arsye:

- 1) Për të simbolizuar qëndrueshmërinë/mbijetesën e qytetërimit nga termeti.
- 2) Kalaja ka qenë një nga zonat më të prekura nga termeti.
- 3) Si përmendore do të jetë pikë referimi për kalimtarët dhe vizitorët.

Zgjidhja vizuele-artistike do të përcaktohet me konkurs.

Në përmendore do të gdhenden emrat e banorëve të Ulqinit që kanë humbur jetën nga termeti.

2. Tipi i monumentit – PËRMENDORE.

3. Përmendoren kushtuar termetit 1979 do ta ndërtojë Komuna.
4. Mjetet për ngritjen do të sigurohen nga grupi i qytetarëve - inicuesit e këtij projekti.
5. Afati për ngritjen e kësaj përmendore është dhjetor 2020.
6. Për realizimin e këtij monumenti, sipas ligjit, do të silllet një vendim i posaçëm.

## II

### **Dispozitat e kalimtare**

Ky program hynë në fuqi ditën e tetë nga data e botimit në „Fletën Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat komunale“.

Nr.: 02-311/19-8

Ulqin, më 30.12.2019

**Kuvendi i Komunës së Ulqinit**

Kryetari i Kuvendit,  
dr. Ilir Çapuni, d.v.